



10 JANAR 2015

ECMI KOSOVA BËN THIRRJE PËR GJAKFTOHTËSI PAS PROTESTAVE KUNDËR DEKLARATËS KONTRAVERSE TË MINISTRIT JABLANOVIĆ

Më 10 janar në Gjakovë u mbajt një protestë paqësore nëpërmjet së cilës protestuesit kërkuan nga Kryeministri Mustafa që ta shkarkonte ministrin Jablanović nga detyra e tij. Protesta e thirrur nga Vetëvendosje dhe OJQ-ja “Thirrjet e Nënave”, ku morën pjesë disa qindra protestues, u mbajt pas deklaratave kontroverse të ministrit të Qeverisë së Kosovës Aleksandar Jablanović. Protesta u mbajt pas një serie të reagimeve të fuqishme në media nga partitë politike opozitare dhe Avokati i Popullit.

Në një deklaratë verbale dhënë mediave, Mr. Jablanović citohet të ketë thënë që “egërsirat nuk lejuan serbët të kthehen në shtëpitë e tyre të djegura”¹ duke komentuar protestën e organizuar nga Vetëvendosje dhe OJQ-ja “Thirrjet e Nënave” më 6 janar, ku pelegrinët serbë nuk u lejuan të hyjnë në kishën ortodokse serbe në Gjakovë duke bllokuar hyrjen e kishës. Deklarata e tij u transmetua nga mediat në gjithë Kosovën, dhe shpejt u dënua nga publiku i gjerë. OJQ-ja “Thirrjet e Nënave”, e cila mbledh rreth vetes nënat e mijëra të zhdukurve që nga viti 1999 në komunën e Gjakovës e cilësoi deklaratën si fyese për ta dhe për kujtimin e të vrarëve dhe të zhdukurve. Avokati i Popullit, Sami Kurteshi, e cilësoi deklaratën si “shoviniste” dhe “shkelja më e rëndë që mund të bëjë një ministër”.² Pas rritjes së presionit nga publiku dhe mediat, ministri Jablanović dha një tjetër deklaratë ku thotë së “ai nuk ishte në dijeni për humbjet katastrofike njerëzore në Gjakovë”, dhe se ai nuk i kishte quajtur egërsira të gjithë qytetarët e Gjakovës, por “vetëm ata që kishin hedhur gurë”.³ Pas deklaratës së dytë të z. Jablanović, Kryeministri shprehu kënaqësinë e tij me shpjegimin e dhënë nga z. Jablanović dhe i bëri thirrje të gjithëve, duke përfshirë udhëheqësit politikë, që të zbusin retorikën dhe të përqendrohen në rindërtimin e urave bashkuese në vend e jo të krijojnë ndasi të reja.⁴

¹ Për më shumë informata, shihni këtu <http://www.telegrafi.com/lajme/jabllanoviqi-i-quan-egersira-protestuesit-ne-gjakove-video-2-56413.html>

² Për më shumë informata, shihni këtu <http://www.rtklive.com/en/?id=2&r=283>

³ Për më shumë informata, shihni këtu <http://www.telegrafi.com/lajme/jabllanoviq-s-kam-gene-ne-dijeni-per-humbjet-katastrofike-ne-gjakove-2-56481.html>

⁴ Për më shumë informata, shihni këtu <http://koha.net/?id=27&l=40234>

ECMI Kosova përsërit qëndrimin e saj se protestat paqësore janë një shenjë e mirë e një shoqërie të shëndoshë demokratike. ECMI Kosova dëshiron që edhe një herë të shpreh shqetësimin e saj me bllokimin e dhunshëm të hyrjes së kishës ortodokse serbe në Gjakovë⁵, si dhe shqetësimin e saj me deklaratën e dhënë nga ministri Jablanović me të cilën i referohej protestuesve si “egërsira”. Çështjet e ndjeshme etnike duhet të trajtohen me kujdes dhe me respektin e duhur për të gjitha palët, dhe viktimat e familjarët e tyre duhet të trajtohen me respektin që ata meritojnë nga të gjitha institucionet dhe shoqëria e Kosovës.

ECMI Kosova u bën thirrje medieve që të mos ngrisin retorikën kur raportojnë për ngjarje si këto. Në gjithashtu porosisim partitë politike që të mos i përdorin çështjet etnike për zënka politike. Përfaqësuesit politikë dhe mediat duhet të përipiqen që në çdo kohë të marrin në konsideratë ndjeshmërinë e të gjitha komuniteteve në Kosovë në punën e tyre për shoqërinë e Kosovës.

Për më shumë raporte dhe analiza politike:

[ECMI Kosova dënon bllokadën e dhunshme të hyrjes së kishës ortodokse serbe në Gjakovë dhe i bën thirrje autoriteteve në Kosovë që të sigurojnë qasje të lirë dhe të papenguar në objektet e kultit](#)

7 janar, 2015

<http://goo.gl/RQZ5A1>

[Përmbledhje politike: Qeverie e re, përfaqësimi i komuniteteve, dhe sfidat në të ardhmen](#)

10 dhjetor, 2014

<http://goo.gl/ztdfOI>

[Buletin Informativ nga ECMI Kosova: Një vështrim i shkurtër mbi situatën e fundit të sigurisë në Kosovë](#)

4 nëntor, 2014

<http://goo.gl/3RyIIC>

[Përmbledhje e shkurtër e zhvillimeve politike nga ana e ECMI Kosovës: Komunitet pakicë dëshirojnë të shohin fundin e ngërçit politik](#)

23 tetor, 2014

<http://goo.gl/sBf53x>

[Partitë politike të minoriteteve në mjedisin politik në ndryshim e sipër në Kosovë](#)

31 korrik, 2014

<http://goo.gl/sSc7dn>

[ECMI Kosova fton për qetësi në përshkallëzimin e tensioneve etnike pas lojës Serbi-Shqipëri](#)

15 tetor, 2014

<http://goo.gl/88dOMR>

[Deklaratë për shtyp – Përngjitja e ndarjes: Themelimi i një bordi të përbashkët për qytetin e Mitrovicës](#)

27 qershor, 2014

<http://goo.gl/d6XKës>

[Zgjedhjet e përgjithshme në Kosovë: Një shikim i çështjeve, sfidave dhe skenës politike në prag të zgjedhjeve të 8 qershorit](#)

⁵ Për më shumë informata, shihni deklaratën e ECMI Kosovë këtu <http://www.ecmikosovo.org/?p=5970>

PRESS RELEASE

2 qershor, 2014

<http://goo.gl/glrHmd>

[Përmbledhje e disa prej ndryshimeve në Projektligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës](#)

17 prill, 2014

<http://goo.gl/nufjM0>

[Transitional Justice, Minority Rights and Communities in Kosovo](#) (Anglisht)

28 mars, 2014

<http://goo.gl/tiQJcF>

[Kosovo Local Elections 2013: Lessons Learnt for Minority Communities](#) (Anglisht)

20 dhjetor, 2013

<http://goo.gl/p2MmME>

Për më shumë informata, ju lutem kontaktoni:

ECMI Kosovo

Tel: + 381 (0) 38 224 473

Email: info@ecmikosovo.org

Web: www.ecmikosovo.org

Rreth ECMI Kosova

ECMI Kosova është organizata kryesore joqeveritare e përfshirë në çështje minoritare në Kosovë, me qëllim të gjithëmbarshtëm që të zhvillojë institucione gjithëpërfshirëse, përfaqësuese, të ndjeshme ndaj komuniteteve e që përkrahin një Kosovë stabile shumetnike. ECMI Kosova kontribuon për zhvillimin, fuqizimin dhe zbatimin e legjislacionit përkatës, përkrah institucionalizimin e organeve qeveritare që punojnë me komunitetet, dhe shton kapacitetet e aktorëve të shoqërisë civile dhe të qeverisë për t'u përfshirë me njëri-tjetrin në një mënyrë konstruktive dhe të qëndrueshme.